



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr.153/2014**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Lëvizjes Vetvendosje (LVV), dega në Prizeren, paraqitur kundër subjektit politik Kosova Demokratik Türk Partisi ,dega në Prizeren , për shkak të vendosjes se banerëve në rrugën publike për Zgjedhjet e Parakohshme per Kuvendin e Republikës se Kosovës , në seancën e panelit të mbajtur me 06.06.2014, mori këtë:

**VENDIM**

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetvendosje (LVV), dega në Prizeren, kështu që subjektit politik Kosova Demokratik Türk Partisi, dega në Prizeren i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 450(katërqind e pesëdhjet) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

**Arsyetim**

Me datën 04.06.2014, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Lëvizja Vetvendosje (LVV) dega në Prizeren me të cilën pretendon se me datën 03.06.2014, aktivistja Marigone Drevinja rreth orës 12.00 ka vërejtur se mbi udhëkryqin që lidhë rrugët “Jeronim de Rada” dhe “Westlez Clark” në Prizeren,aktivistet e subjektit politik KDTP kanë vendosur banerë të kandidatit për Kuvendin e Republikës së Kosovës Enis Kervan nga ky subjekt politik. Me këtë rast parashtresuesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 4.1 pika b të Rregullës Zgjedhore nr.11/2013 dhe Nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2014 të KQZ-së.

Parashtresuesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një fotografi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4,paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, dhe nenit 120 paragrafi 1 pika a) të LZP-së,PZAP me datë 05.06.2014 e informoi subjektin politik Kosova Demokratik Türk Partisi për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet në Kërkesë Përgjigje dhe Urdhër për te Ndërmarr Masat Përmirësuse lidhur me ankesën deri ne date 06.06.2014 në ora 10.00.

Sipas afatit të caktuar, PZAP-i, mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik Kosova Demokratik Türk Partisi në të cilën deklaroi se kandidai i KDTP-së, Enis Kervan nuk e ka vendosur banerin e tij me qëllime provokuese ose prishjes së rendit dhe ligjit.Me tutje ka theksuar se shtabi zgjedhor i KDTP-së ka tërhequr vërejtjen që të bëjë përmirësimin dhe evitim të banereve të tij në afat kohor prej 24 orëve.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**ankesa është e bazuar**

Nga fotografia e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se baneri i kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik Kosova Demokratik Türk Partisi janë të vendosura mbi rrugët publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rëndësuese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rëndësuese mori se subjekti politik Kosova Demokratik Türk Partisi ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se është i njoftuar me rregullat zgjedhore.

Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i mori se subjekti politik Kosova Demokratik Türk Partisi, pas marrjes së Kërkesës Përgjigje dhe Urdhër për të Ndërmarr Masa Përmirësuese nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka theksuar se do të ndërmarrë masat e nevojshme për përmirësimin dhe evitimin e banerit në afatin kohor prej 24 orëve.

PZAP-i duke marrë parasysh të gjitha arsyet e lartcekura se nga ana e subjektit politik Kosova Demokratik Türk Partisi është shkelur neni 33 pika b) të LZP-së, pasi që baneri i kandidatëve të tij është vendosur mbi rrugë publike, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të subjektit politik Kosova Demokratik Türk Partisi që ka ndërmarrë për evitimin e shkeljes si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara siq ka theksuar në përgjigjen në ankesë të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptua, PZAP-i në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 153/2014 më datën 06.06.2014.

**Kryesuesi i Panelit**

**Xhevdet Abazi**



PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5,000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*